



## PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

### Nr. 46

Datë: 15. 07. 2021. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Florian Dushi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Zuvic, Rifat Krasniq, Fazli Stollaj

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misni ; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### RENDI I DITËS

#### **1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së Nr.44 dhe 45/2021.

#### **2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ së:**

#### **3. Aktivitetet e ZRPP-së:**

#### **4. Këshillat e KQZ-së:**

- Këshillit për Çështje Ligjore:

- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Junik.

- **Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë:**

- Njoftim lidhur me pagesën e anëtarësisë së KQZ-së në organizatën AËEB për vitin kalendarik 2021.

**5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimeve për anëtar të jashtëm të Komitetit të Auditimit të Brendshëm të KQZ-së.**

**6. Njoftim nga Këshilli Mbikëqyrës i Informimit Publik.**

**7. Të ndryshme**

---

**1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:** Përshëndetje, po e fillojmë mbledhjen. E kemi agjendën... Unë, do ta propozoj një pikë mbi “Zëvendës kryesuesin e Kryeshefit”, pra caktimin e ushtruesit të detyrës...

Kush është për agjendën e këtij takimit...?

Miratohet rendi i ditës.

Në vazhdim, miratohen procesverbale e mbledhjeve të KQZ-së Nr.44 dhe 45/2021, me një vërejtje të z. Radoniqi që, të anashkalohen përmbajtjet që nuk janë të rëndësishme në procesverbal...

**2.Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së**

**Burim Ahmetaj:** Aktualisht, jemi në fazën e votimit përmes postës! Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datën 9 korrik 2021, një ditë para se të filloj periudha e aplikimit për regjistrim, u ka dërguar aplikacione për regjistrim të gjithë votuesve që suksesshëm kanë aplikuar për regjistrim në Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 14 shkurt 2021.

Aplikacioni për regjistrim dhe informatat për periudhën e aplikimit për regjistrim, iu është dërguar të gjithë votuesve përmes e-mailit. Divizioni i Shërbimit të Votuesve këto materiale dhe informata iu ka dërguar rreth: 79, 083 e-mailave.

Para se të filloj periudha e aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, z. Ahmetaj tha se në ueb faqen e KQZ-së, janë publikuar: Formularët e aplikimit për regjistrim; Procedura për vlerësimin e kriterëve të zotësisë juridike për fitimin e së drejtës së votës; Pyetjet e parashtruara më së shpeshti për periudhën e aplikimit për regjistrim; Informatat e përgjithshme për periudhën e aplikimit.

Periudha e aplikimit për regjistrim, ka filluar me datën 10 korrik 2021. Prej datës 10 korrik 2021 deri me datën 14 korrik 2021, në orën 21:30 janë pranuar gjithsej: 699 aplikacione për regjistrim. Të gjitha aplikacionet janë pranuar përmes e-mailit. Gjithsej, 653 aplikacione janë aprovuar, që do të thotë së aplikuesit kanë plotësuar kriteret juridike për tu përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës.

Por, tha z. Ahmetaj, 46 aplikacione për regjistrim nuk janë aprovuar, për shkak se aplikuesit nuk kanë plotësuar kriteret juridike për tu përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës. Këtyre aplikuesve, Shërbimi i Votuesve u ka dërguar e-mail njoftues për dokumentet që duhet t'i dërgojnë, në mënyrë që të ju aprovohen kërkesat për regjistrim si votues jashtë Kosovës.

Në kuadër të përgatitjeve për zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 17 tetor 2021, Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është në fazën e zhvillimit të programit orientues për anëtarët e KKZ, i cili është duke u zhvilluar me datë 14 dhe 15 korrik. Programi orientues është i ndarë në katër (4) faza përgjatë dy (2) ditëve.

Në vazhdim, z. Ahmetaj e njoftoi KQZ-në lidhur me përgatitjen e Listës Preliminare të Votuesve, aktivitet ky i cili, do të realizohet me datë 20 korrik: me publikimin e listës në Makinën Kërkuese në Ueb faqen e KQZ-së.

Aktivitete tjera janë draft dizajnimi i formave zgjedhore dhe draft plotësim ndryshimi i procedurave të votimit dhe numërimit të cilat do të shqyrtohen fillimisht në Sekretariat. Pas shqyrtimit të parë do të përgatitet drafti i dytë i cili më pastaj do të shqyrtohet nga KQZ, tha në fund z. Ahmeti.

**Arianit Elshani**, në analizë të dërgimit të aplikacioneve për regjistrim dhe informatat për periudhën e aplikimit për regjistrim, propozoi që duke u bazuar në rrethanat dhe kushtet që kanë përcjellë zgjedhjet e jashtëzakonshme të “17 shkurtit”, s'i dhe në problemet që janë shfaqur pastaj, iemell për aplikim tu

dërgohet të gjithë atyre aplikuesve: të suksesshëm, por edhe atyre që kanë qenë të pasuksesshëm në zgjedhjet e fundit. Sot kanë kohë dhe afatet janë më të gjata, dhe kësaj radhe ata mund ti plotësojnë kriteret juridike...

Po ashtu, z. Elshani pyeti rreth zbatimit të udhëzimit të aprovuar dhe vendimit lidhur me përcaktimin e mostrës së verifikimit. Kur planifikohet të zbatohet, dhe s'i do të zbatohet nga Sekretariati...?

**Sami Kurteshi**, tha se pajtohet që imell tu dërgohet të gjithëve, dhe diskutoi edhe rreth “të dhënave personale” që tha se, KQZ duhet të bëjë shumë përpjekje në mbrojtjen e të dhënave të aplikuesve, sidomos “numrat personal” të votuesve...

Ai, propozoi të kontaktohet institucioni për mbrojtjen e të dhënave sepse, tha ai duhet “të diskutojmë në këtë drejtim” sepse, mandej mund të shfaqen probleme...

**Brumi Ahmetaj**, tha se propozimet dhe udhëzimet do të merren sigurisht në konsideratë, sidomos ato vendime që pajtohet edhe KQZ...

### **3. Aktivitetet e ZRPP-së:**

**Yll Buleshkaj**, tha se zyra e ka përgatitur raportin dhe se, më e rëndësishmja është se Kuvendi, më shkurtë Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, e ka përzgjedhur një kompani që do të bëjë Auditimin e Raporteve Financiare të Partive Politike për 3 vitet e fundit...

Më 13 korrik, është bërë edhe tërheqja e shortit, ku secilës parti i është caktuar auditori...

Zyra, i ka të gatshme raportet.

Aktiviteti tjetër, është verifikimi i kandidatëve për postet më të larta publike, dhe ne kemi pranuar një listë për auditor të përgjithshëm, dhe i kemi hasur 2 kandidatë që kanë qenë të angazhuar politikisht 3 vitet e fundit...

Po ashtu, tha z. Buleshkaj, kemi monitoruar kuvendin zgjedhor të partisë “Nova Demokratska Stranka” e cila, e përfaqëson komunitetin boshnjak.

Deri më sot, kemi 6 kërkesa për certifikim dhe jo më shumë, dhe se aplikimet janë në shqyrtim e sipër, tha në fund z. Buleshkaj.

#### **4. Këshillat e KQZ-së: Këshillit për Çështje Ligjore:**

##### **Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Junik:**

**Arianit Elshani:** Këshillit për Çështje Ligjore ka shqyrtuar kërkesën për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Junik, dhe pas shqyrtimit ka aprovuar kërkesën e cila, ka qenë në përputhje me kriterit juridike, dhe ligjet në fuqi.

**Kreshnik Radoniqi:** Atëherë, znj. Zejnepe Gaxherri, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Junik, nga subjekti politik "Lidhja Demokratike e Kosovës- LDK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal, znj. Erleta Isufaj.

Miratohet rekomandimi për zëvendësim të anëtarit të kuvendit komunal.

#### **5. Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë:**

##### **Njoftim lidhur me pagesën e anëtarësisë së KQZ-së në organizatën AËEB për vitin kalendarik 2021.**

**Kreshnik Radoniqi:** E para, jemi takuar si këshill dhe, në mbledhje kemi rekomanduar vetëm një pikë për njoftim. Kemi të bëjmë me pagesën e anëtarësisë së KQZ në organizatën AËB për vitin kalendarik 2021. Për këtë ne duhet të marrim vendim, por paraprakisht ju njoftoj se shuma që duhet paguar për anëtarësi, është 10 000 dollarë. Ne në këshill, jemi marrë vesh që për shkak të shumë zgjedhjeve që i ka pasur si KQZ dhe shpenzimeve, po ashtu edhe për shkak të pandemisë kemi kërkaur që "shuma nga kjo organizatë të zbritet", dhe se na është kthyer përgjigja dhe se na është thënë se kërkesën tonë ata, do ta shqyrtojnë në takimin e radhës...Ne, do të informohemi dhe si KQZ, mbas njoftimit, do të marrim vendim...

**Florian Dushi:** Po njoftohemi se, çështja kryesore e takimit të këshillit është pagesa e anëtarësisë. Kam fatin të jem pjesë e lobimit të KQZ-së në këtë anëtarësim, dhe se ka qenë angazhim yni i jashtëzakonshëm i joni dhe sidomos i kryetares Daka. Ka qenë sfidë sepse, anëtarësimi ynë në ACEEO dhe në AËEB, është kundërshtuar nga të tjerët për arsye politike që Kosova të mos lejohet të jetë anëtarë s'i shtet. Kemi bërë të pamundur që, ne të bëhemi anëtarë në këta organizma me qëllimin e vetëm: që ne të fitojmë përvojë, dhe bashkëpunim me këto trupa menaxhuese të zgjedhjeve...Prandaj, nuk do të duhej në asnjë mënyrë ta rrezikojmë anëtarësinë tonë...

Sa më përket mua, pavarësisht, si institucion çfarëdo të jetë përgjigja, ne duhet ta paguajmë anëtarësinë tonë në këta organizma...

**Ibrahim Selmanaj**, tha se duhet të funksion si shtet, dhe se jo ta zëmë “me hua” ose me këtilla kërkesa, dhe se duke qenë edhe buxhet i ndamë, ne s’duhet ta diskutojmë fare këtë temë...

Të njëjtin mendim, e mbështeti edhe z. Arianit Elshani, Burim Ahmetaj dhe Kreshnik Radoniqi.

#### **5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimeve për anëtar të jashtëm të Komitetit të Auditimit të Brendshëm të KQZ-së.**

**Burim Ahmetaj**, tha se kemi dy shkresa përkrahëse: dy auditorë na janë afruar nga Gjykata Kushtetuese, dhe një nga Këshilli Gjyqësorë i Kosovës. Janë pra tri propozime...

**Sami Kurteshi**: Tani, po rrumbullaksohe komiteti dhe mendoj se mund ta plotësojmë “mozaikun” e komitetit, sepse kemi ekspert auditorë, nga finansasat, prokurimi...

**Kreshnik Radoniqi**: E hedhim në votim...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan propozimet që Besart Maqedonci dhe Fatbardha Grabanica të jenë Auditorë të Jashtëm të Komitetit të Brendshëm të KQZ-së.

#### **6. Njoftim nga Këshilli Mbikëqyrës i Informimit Publik:**

**Fazli Stollaj**: Këshilli ka vazhduar me shqyrtimin e teksteve që kanë për qëllim informimin e qytetarëve me këtë periudhë. Më 12 korrik, janë shqyrtuar tekstet për ndërrimit të QV-e, për periudhën e konfirmimit dhe kundërshtimit, dhe tekstin për caktimin e QV-ve.

Për dy periudhat, do të ketë video dhe spot, kurse për tekstin që ka të bëjë me caktimin e qendrave të votimit, teksti do t’ju dërgohet me postë të gjithë votuesve të rinjë, dhe atyre që e kanë ndërruar qendrën e votimit...

Këshilli, ka vazhduar me punë edhe sot, dhe se kemi shqyrtuar propozimet e dizajnit të logos dhe sloganin e propozuar nga operatori...Sapo të dakordohemi, ne do t’i sjellim për shqyrtim në KQZ...

#### **7. Të ndryshme !**

